



**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
KRYETARI**

Adresa: Rruga "Abdi Toptani", nr.1, Tiranë;

E-mail: klsh.org.al; www-site:www.klsh.org.al

Nr. **860** / 5 Prot.

Tiranë, më 19/ 12/ 2019

V E N D I M

Nr. 146 , Datë 19.12.2019

**PËR
AUDITIMIN E USHTRUAR NË DREJTORINË ARSIMORE
RAJONALE FIER
"Mbi auditimin financiar dhe të përputhshmërisë për periudhën
01.01.2018 deri më datën 31.08.2019.**

Nga auditimi i ushtruar në "Drejtorinë Arsimore Rajonale Fier" rezultoi që në përgjithësi veprimtaria e këtij institucioni është kryer në përputhje me rregullat, kuadrin ligjor dhe dispozitat e tjera që rregullojnë veprimtarinë e arsimit parauniversitar. Krahas anëve pozitive u konstatuan dhe të meta dhe mangësi në funksionimin e disa komponentëve të sistemit të kontrollit të brendshëm, dobësi në zbatimin e dispozitave ligjore dhe akteve në fushën e kontabilitetit dhe raportimit financiar, mungesa e akteve nënligjore apo nevoja për përmirësimin e tyre, etj.

Pasi u njoha me Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe Projektvendimin e paraqitur nga Grupi i Auditimit të Departamentit të Auditimit të Institucioneve Qendrore, shpjegimet e dhëna nga subjekti i audituar, si dhe vlerësimet mbi objektivitetin dhe cilësinë e auditimit nga Drejtori i Departamentit të mësipërm, Drejtorja e Standardeve dhe Sigurimit të Cilësisë si dhe Drejtori i Përgjithshëm, në mbështetje të neneve 10, 15, 25 dhe 30, të ligjit nr.154/2014 miratuar në datën 27.11.2014 "Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit",

VENDOSA

I. Të miratoj Raportin Përfundimtar të Auditimit "Për auditimin financiar dhe të përputhshmërisë" të ushtruar në "Drejtorinë Arsimore Rajonale Fier", sipas programit të auditimit nr. 860/1, datë 31.10.2019 për veprimtarinë nga data 01.01.2018 deri më datën 31.8.2019.

II. Të miratoj opinionin e auditimit, rekomandimet për përmirësimin e gjendjes dhe të kërkoj marrjen e masave sa vijon:

A. OPINIONI I AUDITIMIT:

Baza për opinionin mbi ligjshmërinë dhe rregullshmërinë (ISSAI 4000¹):

I. Nga auditimi financiar: Në mbajtjen e kontabilitetit dhe kryerjen e pagesave në DAR/ZVA Fier janë konstatuar disa parregullsi; është përfshirë në pasqyrat financiare vlera e objekteve ndërtimore që janë në administrim të pushtetit vendor; konstatuar mangësi dhe parregullsi në kryerjen e të gjithë fazave të inventarizimit fizik të aktiveve, parregullsi në marrjen në dorëzim të mallrave dhe shërbimeve; mungojnë regjistrimet e pasurisë në ZVRPP dhe për objektet ndërtimore mungojnë dokumentacionet respektive justifikuese si genplane, planimetri dhe planvendosje dhe aktet e vlerësimit; shpenzime pa efektivitet për fondet e buxhetit prej 24,8 milionë lekë, etj.

Opinion:

Nga **auditimi i pasqyrave financiare**, mbështetur në Standardet Ndërkombëtare të Auditimit, Rregulloren e Procedurave të Auditimit të KLSH dhe Manualin e Auditimit Financiar, përsa i takon shkallës së zbatimit nga subjekti Drejtoria Arsimore Rajonale Fier, të standardeve të kontabilitetit, të ligjit mbi kontabilitetin dhe pasqyrat financiare, udhëzimeve e kushteve të vendosura apo termave mbi raportimin financiar, mbi të cilat është rënë dakord (*kriteret e auditimit financiar*), u evidentua se informacioni financiar i këtij subjekti, është paraqitur në përgjithësi në përputhje me kuadrin rregullator të raportimit financiar dhe se pasqyrat financiare paraqesin në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale kornizën e zbatueshme të raportimit financiar. Megjithatë, nga auditimi i pasqyrave financiare, mbështetur në Standardet Ndërkombëtare të Auditimit dhe Standardin ISSAI 1700, u konstatuan edhe anomali në plotësimin e pasqyrave financiare dhe zbatimin e kuadrit ligjor dhe rregullator në fuqi (të paraqitura më lartë), të konsideruara **materiale, por jo të përhapura, për të cilën japim opinion të kualifikuar²**”

II. Nga auditimi mbi përputhshmërinë³: sa i takon shkallës së zbatimit nga subjekti DAR Fier, të rregullave, ligjeve dhe rregulloreve, politikave, kodeve të vendosura apo termave dhe kushteve, mbi të cilat është rënë dakord (kriteret e auditimit të përputhshmërisë), u evidentuan në përgjithësi zbatimi tyre por edhe disa raste të devijimeve nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi (kriteret), që nën gjykimin profesional të audituesit të pavarur nuk janë materiale, të cilat kryesisht, konsistojnë në drejtim të: respektimit të kërkesave të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm publik, mosveprime në plotësimin e strukturës organike, risqeve në funksionimin e portalit të punësimit të mësuesve, hartimit të rregullave të brendshme për gjurmët e auditimit në funksion të zbatimit të akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi, etj.

Opinion:

Nën gjykimin tonë, aktiviteti i DAR Fier, kontrollat e brendshme të zbatuara paraqesin në të gjitha aspektet materiale, në mënyrë të drejtë aktivitetin e këtij institucioni, në përputhje me dispozitat ligjore që rregullojnë përputhshmërinë me kuadrin ligjor në fuqi.

Nga auditimi i përputhshmërisë, mbështetur në Standardet Ndërkombëtare të Auditimit, ISSAI 400, Rregulloren e Procedurave të Auditimit të KLSH dhe në Manualin e Auditimit të

¹ ISSAI 4000 – Objektivi i audituesve në një auditim përputhshmërie është të japë siguri të arsyeshme nëse informacioni i mbledhur sa i takon një çështjeje të veçantë është në përputhje, në të gjitha aspektet materiale, me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi, kur auditimi bëhet lidhur me çështje të veçanta.

²- Sipas **Manualit të Auditimit Financiar** të KLSH-së, kapitulli IV, pika 4.2, “Opinionin me rezerve” do të jepet në rastet kur audituesi nuk është dakord ose është i pasigurt për një ose më shumë çështje specifike që bëjnë pjesë në pasqyrat financiare të cilat janë materiale, por jo thelbësore për arsyetimin e pasqyrave. Nëse efekti financiar i paqartësisë apo i mosmarrëveshjes është i përcaktuar si shumë nga audituesi, ndonëse nuk është gjithmonë e praktikuar ose e përshtatshme, atëherë kjo do të shërbente si ndihmë për përdoruesit e pasqyrave.

³ Mbështetur mbi ligjin nr. 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e KLSH-së”.

Përputhshmërisë së KLSH-së, i kryer në Drejtorinë Arsimore Rajonale/Zyrën Arsimore Vendore Fier u konstatuan edhe devijime nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi, të konsideruara *jo materiale* dhe *jo të përhapura*, për të cilën japim **opinion të pakualifikuar**⁴.

B. PROPOZIME PËR NDRYSHIME APO PËRMIRËSIME NË LEGJISLACIONIN NË FUQI:

1. -Gjetje nga auditimi:

Udhëzimi i MASR-së Nr. 13, datë 22.05.2019, “Për procedurat e pranimit e të emërimit të mësuesit në një vend të lirë pune në institucionet arsimore publike të arsimit parauniversitar dhe për administrimin e portalit “Mësues për Shqipërinë””, ka disa boshllëqe e mangësi që evidentohen nga zbatimi i tij në praktikë dhe prandaj lind nevojë për përmirësim:

- a. Komisioni *ad hock* që ka funksionuar sipas Udhëzimit të MAS-it Nr. 38, datë 06.10.2015, “Për procedurat e lëvizjes paralele, emërimit dhe largimit nga puna të mësuesit në institucionet publike të sistemit arsimor parauniversitar” dhe më pas operon sipas Udhëzimit të MASR-së Nr. 13, datë 22.05.2019, “Për procedurat e pranimit e të emërimit të mësuesit në një vend të lirë pune në institucionet arsimore publike të arsimit parauniversitar dhe për administrimin e portalit “Mësues për Shqipërinë””, ka hartuar regjistrin e pasqyrimin të vendimeve për emërimet apo transferimet /lëvizjet paralele e të detyrueshme, por ky dokument nuk është i sekretuar. Në disa raste, konstatohet se ka korrigjime të tij dhe disa vendime janë administruar në dosje si fotokopje. Mungojnë rregullat dhe përcaktimet e unifikuara nga MASR dhe DPAP mbi mënyrën e hartimit, sekretimit dhe administrimit të këtyre regjistrave dhe dokumenteve.
- b. Audituesit e autorizuar të KLSH-së vërejnë se ZVA-ja Fier nuk ka faqe elektronike për atë kohe ka funksionuar Udhëzimi nr.38/ 2015 ku të shpallë njoftimet për procedurat e punësimit; nga konstatimet sipas Udhëzimit të MASR-së nr. 13, datë 22.05.2019, “Për procedurat e pranimit e të emërimit të mësuesit në një vend të lirë pune në institucionet arsimore publike të arsimit parauniversitar dhe për administrimin e portalit “Mësues për Shqipërinë” si dhe mungon një strukturë/person përgjegjës për hedhjen e të dhënave në sistemin e transparencës.
- c. Prania në portalin “Mësues për Shqipërinë” e kategorisë së mësuesve, nëndrejtorëve, drejtorëve të shkollave etj., argumentohet si aspiratë e tyre për t’i dhënë mundësi vetes për lëvizje paralele me dëshirë apo punësim nga portali, në rast lirim apo largimi nga puna, në tejkallim të synimeve të këtij portali, ku në pikën nr. 1 të udhëzimit theksohet se qëllimi i udhëzimit është rregullimi i procedurës së pranimit, të emërimit për një vend të lirë pune dhe të lëvizjes paralele të mësuesit.
- d. Në Udhëzimin e MASR-së Nr. 13, datë 22.05.2019, “Për procedurat e pranimit e të emërimit të mësuesit në një vend të lirë pune në institucionet arsimore publike të arsimit parauniversitar dhe për administrimin e portalit “Mësues për Shqipërinë””, mungon roli mbikëqyrës i drejtuesit të ZVA dhe DRAP mbi procesin e pranimit të mësuesve, duke ja lënë këtë funksion vetëm komisionit *ad hock*. Për sa sipër, kërkohet një bashkërendim dhe harmonizim më i mirë i dispozitave të ligjit nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në RSH” me ndryshimet dhe përcaktimeve të ligjit nr.10296/2010 “ Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” me ndryshimet.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2, faqe 23-26 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

⁴ - Sipas *Manualit të Auditimit të Përputhshmërisë* të KLSH-së, (fq.65), kapitulli V, pika 5.4, “Opinion i pakualifikuar”, Kur audituesi nuk ka raste mospërputhshesh materiale për të raportuar, kur konkludon ai shpreh një konkluzion të pamodifikuar

1.1.-Rekomandimi:

Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar (ZVA) Fier në bashkëpunim me Drejtorinë Rajonale të Arsimit Parauniversitar (DRAP) Fier të marrin masa për ti paraqitur Ministrisë së Arsimit, Sporteve dhe Rinisë drejtimet e mundshme për përmirësimin e Udhëzimit Nr. 13, datë 22.05.2019, “Për procedurat e pranimit e të emërimit të mësuesit në një vend të lirë pune në institucionet arsimore publike të arsimit parauniversitar dhe për administrimin e portalit “Mësues për Shqipërinë””, veçanërisht në lidhje me aspektet e inkuadrimit të përvojës në vlerësim, mënyrën e hartimit dhe sekretimit të regjistrit dhe administrimit të dokumentacionit të rekrutimit dhe lëvizjeve paralele e të detyrueshme të arsimtarëve, rolit koordinues dhe monitorues të DRAP mbi proceset e lëvizjeve paralele, transparencën dhe shpalljen e publikimin në faqen elektronike të ZVAP dhe DRAP të njoftimeve për procedurat e punësimit, etj.

Brenda 60 ditëve

C. MASA ORGANIZATIVE:

1. -Gjetje nga auditimi:

Nga auditimi u konstatua se nuk janë përgatitur raportet e monitorimit për periudhën objekt auditimi dhe rrjedhimisht nuk i janë paraqitur Ministrisë së Arsimit dhe Sportit; mungon një informacion i plotë me shpjegimet përkatëse lidhur me ndryshimet e buxhetit nga plani fillestar deri në atë përfundimtar, në nivel programi dhe artikulli, lidhur me ndryshimet e planit të produkteve, si në sasi dhe në vlerë. Gjithashtu konstatohet se, për të dy vitet objekt auditimi. institucioni nuk ka publikuar raportet e monitorimit në faqen zyrtare të tij.

Sa sipër, është vepruar në kundërshtim me përcaktimet e Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar; dhe paragrafin nr. 33, Kreu IV “Monitorimi”, të Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 22 datë 17.11.2016, “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit në njësitë e qeverisjes qendrore”.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 1, faqe 11-16 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

1.1-Rekomandimi:

1.Strukturat përgjegjëse për planifikimin dhe monitorimin e shpenzimeve buxhetore në DAR/ZVAP dhe DRAP, gjatë hartimit të raportit të monitorimit dhe raporteve periodike për Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, të argumentojnë mosrealizimin e produkteve dhe të parashikojnë masat që duhen ndërmarrë në të ardhmen për realizimin e tyre. Institucioni të marrë masa për dorëzimin e raporteve 4-mujore të monitorimit në Ministrinë e linjës si dhe publikimin e tyre në faqen zyrtare, referuar Udhëzimit të sipërpërmendur.

2.Të gjitha programet e DRA/ZVAP gjatë hartimit të raportit të monitorimit dhe raporteve periodike të cilat përpunohen nga specialisti i buxhetit dhe dorëzohen në Ministrinë e Arsimit, Sporteve dhe Rinisë, duhet të trajtojnë detyrimet e institucionit, të japin argumente në lidhje me krijimin e tyre si dhe masat që parashikohet të merren për likuidimin e tyre.

Periodikisht, çdo katër mujor

2. -Gjetje nga auditimi:

Mungesat në plotësimin e strukturës organike për DRAP Fier dhe për ZVA-të e juridiksionit të saj, duke krijuar një risk operacional prej më shumë se 6 muajsh.

- Në strukturën e DRAP Fier janë tetë pozicione pune vakant, që në gjykimin tonë ndikojnë në një performacë jo të mirë të punës së institucionit nisur edhe nga funksionet e rëndësishme të këtyre pozicioneve.
- Gjithashtu, ZVA Fier ka mungesë të personelit punonjës dhe konkretisht në Sektorin Shërbimeve një specialist, në Sektorin e Monitorimit të Kurrikulës dhe Zhvillimit Profesional një përgjegjës sektori si dhe shtatë specialist. Pra në strukturën e ZA Fier janë nëntë pozicione pune vakant, që në gjykimin tonë ndikojnë në një performacë jo të mirë të punës së institucionit nisur edhe nga funksionet e rëndësishme të këtyre pozicioneve.

Sa sipër, nuk ka gjetur zbatim të plotë Vendimi i KM nr.99, datë 27.02.2019 “Për krijimin, mënyrën e organizimit e të funksionimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar”, Urdhri i Kryeministrit nr.68, datë 05.04.2019 “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Drejtorisë së Përgjithshme dhe Drejtorive Rajonale të Arsimit Parauniversitar” si dhe kërkesat e Urdhrit nr. 234, datë 19.4.2019 “Për miratimin e strukturës dhe të organikës të Zyrave Vendore të Arsimit Parauniversitar”.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 3, faqe 27-56 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

2.1. Rekomandimi:

Drejtori i ZVA Fier në bashkëpunim me Drejtorin e DRAP, DPAP dhe MASR të marrin masa dhe të fillojnë procedurat për rekrutimin e stafit në pozicionet vakante në zbatim të Urdhrit të Kryeministrit nr.68, datë 05.04.2019 “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Drejtorisë së Përgjithshme dhe Drejtorive Rajonale të Arsimit Parauniversitar” dhe urdhrit nr. 234, datë 19.4.2019 “Për miratimin e strukturës dhe të organikës të Zyrave Vendore të Arsimit Parauniversitar”, pasi mungesat në strukturë (pozicionet vakante) janë 53 % për Drejtorinë Rajonale të Arsimit Parauniversitar (DRAP) Fier dhe 64 % për Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar (ZVA) Fier .

Menjëherë

3. -Gjetje nga auditimi:

Nga auditimi i ushtruar janë konstatuar dobësi në dokumentimin dhe marrjen në dorëzim të mallrave dhe furnizimit me shërbimin e internetit. Fatura tatimore e shitjes është firmosur vetëm nga ofruesi i shërbimit dhe magazinieri, por jo nga strukturat përgjegjëse në DAR/ZVAP.

Nga auditimi i urdhër shpenzimeve për blerje të vogla të realizuara nga DARF/ ZVAP për periudhën 2018-2019, u konstatua se mungonte relacioni nga komisioni i ngritur për marrjen në dorëzim dhe vlerësimin e mallrave, për të verifikuar nëse specifikat e mallit / shërbimit të marrë në dorëzim janë në përputhje me kriteret e parashikuara, në kundërshtim me Udhëzimin e MF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në njësitë e Sektorit Publik”, paragrafët 42-50.Sa sipër, është vepruar në kundërshtim me përcaktimet e Ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar me ligjin nr.110/2015 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 10296, datë 8.7.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”; dhe Udhëzimin e Ministrit të Financave nr.30, datë 27.12. 2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar. Mos dokumentimi i rregullt me procesverbal dhe situacion të nënshkruar nga përfaqësuesit e subjektit dhe institucionit shtetëror rrezikon besueshmërinë e kryerjes së shpenzimit si dhe procesin e gjurmimit të transaksionit.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 3, faqe 27-56 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

3.Rekomandimi:

3.1. Institucioni i ZVAP të marrë masa për të gjitha rastet e kryerjes së shpenzimeve për blerje të mallrave dhe kryerjen e shërbimeve, të përpilojë rregullisht dokumentacionin justifikues përkatës që vërteton kryerjen efektive të furnizimit dhe shërbimit, apo marrjen në dorëzim të aktiveve sipas kushteve të kontratës. Vëmendja e veçantë nga nëpunësi zbatues i njësisë shpenzuesi duhet të tregohet në likuidimin e shërbimeve të kryera për emergjencë, duke i bashkëlidhur me faturën e furnitorit, situacionet e shpenzimeve për shërbimet dhe riparimet, dhe dokumentuar në përputhje me kërkesat e parimet e menaxhimit financiar publik.

3.2. Të merren masa, që për çdo marrje në dorëzim të mallrave dhe shërbimeve, të ngrihet komisioni i marrjes në dorëzim, i cili duhet të përpilojë procesverbalin nëse mallrat/shërbimet janë në përputhje me të dhënat e verifikuara, me faturën dhe kushtet e kontratës, pastaj të bëhet fletë-hyrja në magazinë dhe regjistrimi i tyre në kontabilitet.

Në vazhdimësi

4. -Gjetje nga auditimi:

Mungon pasqyrimi në kontabilitet i vlerës së tokës në administrim të ish-DAR dhe aktualisht në DRAP dhe ZVA zëri "Toka, troje e terrene" duhet të ishte pasqyruar vlera prej 20,044,922 lekë, shifër kjo e konsideruar materiale në dhënien e opinionit mbi pasqyrat financiare, nga zero lekë e pasqyruar në bilancin e periudhës që auditohet.

Rezulton se mungojnë dokumentacionet dhe planimetritë për sipërfaqet e tokave, trojeve dhe terreneve që DAR Fier ka patur në dispozicion për periudhën objekt auditimit, si dhe nuk është kryer përditësimi e azhurnimi i tyre i plotë, përmes matjeve fizike, azhurnimit dhe rakordimit me informacionin e administruar nga zyrat e kadastrës shtetërore dhe të hipotekës.

Konstatohet se, sipërfaqet e evidentuara të tokave dhe trojeve në llogarinë nr.210 si dhe vlera e tyre për DAR Fier në vitin 2015, 2016, 2017 dhe 2018 nuk janë regjistruar në bilancin kontabël dhe janë evidentuar për vlefën 0 lekë. Kjo çështje për grupin e auditimit konsiderohet materiale, pasi, bazuar në VKM nr. 89, datë 3.2.2016, "Për miratimin e vlerës së hartës së tokës në Republikën e Shqipërisë", (*Harta sipas Fletores Zyrtare nr.14, viti 2016, faqe 882*), vlera e pasurisë së paluajtshme të tokës truall për qytetin e Fierit, (referuar çmimeve të vitit 2014), përcaktohet me çmimin prej 12,458 lekë/m², që për zonën kadastrale nr. 8531 dhe 8532, në referencë të VKM nr. 89, datë 3.2.2016 rezulton vlera 20,044,922 lekë, e cila nuk është pasqyruar në kontabilitetin e njësisë arsimore vendore.

Për sa sipër, është vepruar në kundërshtim me ligjin nr.9228, datë 29.04.2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", i ndryshuar; ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe Kontrollin", i ndryshuar; ligjin nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen qendrore", pushteti lokal është kompetent, administron dhe përgjigjet për objektet arsimore; VKM nr. 204, datë 26.03.21998 "Për kompetencat, detyrat funksionale dhe financimin e pushtetit vendor", i ndryshuar; dhe VKM nr. 89, datë 3.2.2016, "Për miratimin e vlerës së hartës së tokës në Republikën e Shqipërisë".

(Më hollësisht trajtuar në pikën 3, faqe 27-56 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

4. Rekomandimi:-

4.1. Drejtori i DRAP dhe drejtori ZVAP të ngrenë një grup pune për të rakorduar me organet e vetëqeverisjes vendore dhe kryer procedurat e transferimit në përputhje me ligjin dhe saktësimin e kësaj shtate,

4.2. Për një pasqyrim të drejtë në kontabilitet të vlerës së tokave, trojeve dhe terreneve në pronësi dhe administrim të DRAP Fier/ ZVA Fier bëhet domosdoshmëri azhurnimi dhe pasqyrimi në kontabilitetin e institucionit i vlerave të këtyre pasurive në referencë të hartës së vlerës së tokave, të miratuar sipas VKM nr. 89, datë 3.2.2016 nga ana e vlerësuesit të pavarur. Pas rakordimit me organet e qeverisjes vendore për objektet shkollorë në administrimin e tyre dhe saktësimin të

sipërfaqeve të tokave dhe trojeve në administrim të DRAP Fier/ ZVA Fier, të kryhen përlllogaritjet dhe pasqyrohen në kontabilitet efektet financiare sa sipër.

4.3.Sektori i Shërbimeve të Përgjithshme të kryejë sistemimet në kontabilitet dhe të reflektojë korrigjimet e duhura në pasqyrat financiare që do të mbyllen për vitin 2019, për efektet e këtyre transferimeve.

Deri më 28 shkurt 2020

5. -Gjetje nga auditimi:

Procedurat e inventarizimit të pasurisë evidentojnë parregullsi e të meta, pasi janë kryer dy herë me radhë në të njëjtin vend nga i njëjti komision; nuk është ngritur Komisioni i Vlerësimit të Aktiveve; nuk është hartuar raporti i vlerësimit të aktiveve afatgjata të trupëzuara,

5.1. Procesi i inventarizimit të pasurisë është kryer nga i njëjti komision, veprime këto jo në përputhje me përcaktimet e pikës 84, të Udhëzimit nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar, ku shprehimisht citohet: *“Inventarizimi periodik i aktiveve nuk mund të bëhet dy herë me radhë në të njëjtin vend nga i njëjti komision”*.

5.2. Konstatohet se nuk është hartuar urdhri nga ana e titullarit të DAR, për ngritjen e Komisionit të Vlerësimit të Aktiveve, si dhe nuk është hartuar raporti i vlerësimit të aktiveve afatgjata të trupëzuara për të propozuar nxjerrjen përfundimisht jashtë përdorimit të tyre, ku duhet pasqyruar vlera fillestare si dhe amortizimi i akumuluar në vite.

5.3. Nuk është hartuar raporti për inventarizimin e aktiveve gjendje në magazinë, në përdorim të punonjësve në zyra dhe ambientet e DAR-it, në kundërshtim me UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, pika 85/c, sipas të cilit komisioni ka përgjegjësinë: *“Të përpilojë një raport lidhur me inventarizimin fizik të aktiveve, për kushtet e ruajtjes së tyre, gjendjen fizike dhe për vërejtjet lidhur me karakterin e diferencave e dëmtimeve të konstatuara, për shkaqet e tyre dhe personat përgjegjës, dhe, së bashku me gjithë dokumentacionin e inventarizimit, t'ia dorëzojë për veprime të mëtejshme Nëpunësit Autorizues”*.

5.4. Nuk janë prerë fletë daljet për nxjerrjen nga përdorimi të AQT pasi për elementet e inventarit të kaluar punonjësve janë prerë fletëdalje të përhershme, duke shmangur gjurmën e auditimit për këto lëvizje. Konstatohet se janë mbajtur librat e magazinës, por nuk janë kryer rakordime dhe kundërfirmime periodike midis Sektorit të Shërbimeve të Përgjithshme / pjesa e financës me personin e ngarkuar për administrimin material.

Për sa sipër, është vepruar në kundërshtim me ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare”, i ndryshuar dhe UMF nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 3, faqe 27-56 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

5.-Rekomandimi:-

5.1. Nëpunësi autorizues dhe nëpunësi zbatues i ZVAP të analizojnë rezultatet e grupeve të inventarizimit dhe të procedojnë në përputhje me kërkesat e UMF nr. 30, datë 27/12/2011, me ndryshimet, duke iniciuar procesin e vlerësimit të aktiveve të propozuara për dalje nga përdorimi në njësinë shpenzuese; listën e aktiveve të identifikuar për vlerësim; kriterin për vlerësimin e aktiveve; relacionin e vlerësimit; dhënien në përdorim/tjetërsimin e aktiveve të panevojshme dhe/ose nxjerrjen jashtë përdorimit të aktiveve; procesverbalin për dhënien në përdorim/tjetërsimin e aktiveve dhe nxjerrjen jashtë përdorimit të aktiveve si dhe përgjegjësitë për nxjerrjen nga përdorimi ose tjetërsimin e aktiveve të panevojshme, në referencë të paragrafit 95 e vazhdim, të Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

5.2. Nga strukturat e menaxhimit të ZVAP Fier dhe DRAP Fier të merren masa që kryerja e inventarëve të aktiveve, nxjerrja jashtë përdorimit dhe asgjësimi i tyre, të shoqërohen me procesverbalet e nxjerrjes jashtë përdorimit dhe asgjësimit të aktiveve, bashkëlidhur me dokumentacionin mbi procedurën e kryer për vlerësimin dhe ndarjen e materialeve sipas destinacionit të tyre, për ankand, grososje, vend ndodhjen e grososjes së tyre, djegien, etj, shoqëruar me fotot përkatëse, mjetin e transportit i cili ka kryer transportin e tyre, duke e dokumentuar nxjerrjen jashtë përdorimit dhe asgjësimin e materialeve në përputhje me UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”

Vazhdimisht

6. -Gjetje nga auditimi:

Vlerësimi i riskut është një proces pak i zhvilluar në praktikë nga drejtuesit e programeve buxhetore.

6.1. Nga auditimi u konstatua se, rastet konkrete të vlerësimit të riskut janë praktika pak të zhvilluara në praktikë. Nga ana tjetër, për natyrën e veçantë të këtij subjekti publik, koncepti i “Menaxhimit të Riskut” dhe vendosja e kontrolleve si përgjigje ndaj tij, mbetet një çështje që kërkon vëmendjen e posaçme nga drejtuesit e ZVA. Nuk janë përmbushur detyrimet në kuadër të përgjegjshmërisë menaxheriale, për identifikimin dhe krijimin e Regjistrit të Risqeve, mungon monitorimi i kontrolleve të risqeve që vënë në rrezik arritjen e objektivave dhe realizimin me sukses të veprimtarive, sipas kërkesave të neneve 10 , 11 /2, 12 /3, 9.4 /c dhe 21 të ligjit nr. 10296/ 2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar.

Për periudhën objekt auditimi, nuk ishte hartuar Regjistri i Risqeve dhe Strategjia për Menaxhimin e Risqeve, detyrimi i neneve 8 (pika 8/a), të ligjit nr. 10296/2010. Në mënyrë më të detajuar, përgjegjshmëria e hallkave të ndryshme në këtë njësi publike, rregullohet nga kjo dispozitë ligjore si më poshtë vijon:

“Titullarët e njësive publike në fushën e menaxhimit financiar dhe kontrollit kanë këto kompetenca kryesore:

a) hartimin e politikave, miratimin dhe monitorimin e objektivave të njësive publike që ata drejtojnë, të planeve strategjike e vjetore, përfshirë strategjinë e menaxhimit të riskut dhe të plan-veprimeve për arritjen e objektivave;

b) ngritjen e grupit të menaxhimit strategjik të njësisë publike, në përputhje me kërkesat e nenit 27 të këtij ligji;

6.2.Për periudhën objekt auditimi, nuk ishte hartuar Strategjia për Menaxhimin e Risqeve dhe plani i veprimtimit që shoqëron aktivitetet, detyrimi i neneve 10 dhe 21/ 2, të ligjit nr. 10296/ 2010, ku theksohet se:

“Për t’i zbatuar veprimtaritë e përcaktuara në pikën 1 të këtij neni, titullari i njësisë publike miraton një strategji, e cila përditësohet çdo tre vjet ose sa herë që ka ndryshime thelbësore të mjedisit të riskut. Nëpunësi autorizues analizon dhe përditëson kontrollet që synojnë minimizimin e riskut, të paktën një herë në vit.”

si dhe përcaktimet e kreut III, pika 3.2 të Manualit të MFK, miratuar me urdhrin e Ministrit të Financave nr. 108, datë 17.11.2016, që nënvizon se:

“Çdo NjQQ duhet të përgatisë dhe të miratojë një strategji të menaxhimit të riskut që përditësohet rregullisht (çdo tre vjet) ose kur në mjedisin e riskut ndodhin ndryshime të rëndësishme. Strategjia duhet të përgatitet nga NA në cilësinë e KR. Titullari i njësisë miraton strategjinë e menaxhimit të riskut. NA analizon dhe përditëson kontrollet që synojnë minimizimin e riskut të paktën një herë në vit”.

6.3.Nga analiza e rubrikave të plotësuara të Pyetësorit sipas komponentëve mbi MFK, konstatojmë se vlerësimet e Sistemit të Kontrollit të Brendshëm dhe Menaxhimit Financiar janë kryer për çdo komponent, por për vitin 2018 nuk kanë gjetur zbatim detyrimet e pikës nr. 17, të

Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 28, datë 15.12.2011, “Mbi paraqitjen e Deklaratës dhe Raportit vjetor për cilësinë e sistemit të kontrollit të brendshëm në njësitë publike”, pasi Raporti për funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm nuk ka të përfshira gjetjet dhe rekomandimet e auditimit të brendshëm dhe të jashtëm si dhe nuk referon një plan veprimi për të ardhmen, sikundër përcaktohet në këtë udhëzim. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 6, faqe 67-71 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

6.-Rekomandimi:

6.1. ZVAP Fier dhe DRAP Fier të marrin masa që të plotësohet me të gjithë sektorët dhe aktivitetet, i pyetësorit të vetëvlerësimit për sistemin e kontrollit të brendshëm si dhe regjistri i riskut; të bëhet përditësimi, miratimi dhe dërgimi i tij në Drejtorinë e Buxhetit dhe Drejtorinë e Financës së Ministrisë së Arsimit, Sporteve dhe Rinisë, për të mundësuar vendimmarrje cilësore, optimizimin e burimeve në dispozicion, që kanë të bëjnë me prioritetet dhe shmangien e problemeve që mund të shfaqen gjatë punës për arritjen e objektivave të vendosura, konformë përcaktimeve të kreut III, pika 3.2 “Menaxhimi i riskut”, të Manualit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin.

6.2. DRAP Fier/ ZVA Fier të rishikojë çdo vit dhe përditësojë Regjistrin e Risqeve kryesore dhe kontrolleve përkatëse kompensuese, që do të ndërtohen me synimin që të ndihmojnë në zbutjen e pasojave dhe mundësive të tyre si dhe miratojë Strategjinë e Menaxhimit të Risqeve, sipas fokusit, prioriteteve dhe qëllimeve afatmesme e afatgjata bazë që ka ky institucion, në zbatim të neneve 10 dhe 21, të ligjit nr.10296, datë 08.07.2010, “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”.

Vazhdimisht

7. -Gjetje nga auditimi:

Mungesa e planit të trajnimeve dhe e hartës së proceseve të punës në Institucionin e ZVA Fier si dhe rezultojnë dobësi në përgatitjen e hartës së proceseve dhe manualeve të proceseve të punës. Më konkretisht:

7.1.Për ruajtjen dhe zhvillimin e kompetencave profesionale njësia arsimore vendore nuk disponon plane të trajnimeve dhe mungon një data-base mbi trajnimet dhe kualifikimet e stafit të institucionit publik, për periudhën e audituar nga KLSH. Sa më sipër, nuk kanë gjetur zbatim kërkesat e pikës nr. 3/1, nën çështja “Politikat dhe praktikat që lidhen me burimet njerëzore”, të Kapitullit III të Manualit të MFK, miratuar nga Ministri i Financave me urdhrin nr. 108, datë 17.11.2016. Nuk janë kryer trajnime të stafit në drejtim të në drejtim njohjes së dispozitave të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe të menaxhimit të sistemit buxhetor, me qëllim rritjen e efikasitetit dhe efikasitetit të punës dhe menaxhimin e fondeve publike së njësisë shpenzuese buxhetore.

7.2.U verifikua zbatimi i kërkesave të pikës 3.3, të manualit të MFK, mbi përgatitja e hartës së proceseve dhe manualeve të proceseve të punës. Këto manuale garantojnë uniformitetin në kryerjen e proceseve të punës, identifikimin e aktiviteteve të kryera, përgjegjësitë për kryerjen e një aktiviteti, si dhe afatet brenda të cilave këto aktivitete duhet të kryhen së bashku me një pamje të përgjithshme të veprimtarive të kontrollit që identifikohen brenda një procesi dhe që garantojnë përmbushjen e objektivave të procesit. Auditimi i KLSH-së vëren se, ka një moskuptim të domosdoshmërisë së ekzistencës së përshkrimit të proceseve të punës. *Jo vetëm kaq, por përshkrimi i procesit të punës konfundohet me përshkrimin e pozicionit të punës.* *(Më hollësisht trajtuar në pikën 6, faqe 67-71 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

7.-Rekomandimi:

7.1.Nga DRAP Fier/ ZVA Fier në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit, Sporteve dhe Rinisë, në përputhje të plotë me kërkesat e ligjit të menaxhimit financiar dhe kontrollit, të merren masat e duhura për parashikimin e nevojave për zhvillimin e kompetencave profesionale të punonjësve, dhe në bazë të këtyre parashikimeve të hartohen dhe kryhen trajnime dhe seminare, nga Shkolla Shqiptare e Administratës Publike (ASPA) dhe nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, veçanërisht mbi aspektet e analizës së Menaxhimit të Riskut, për menaxhimin e buxhetit dhe aktiveve në dispozicion, prokurimin publik elektronik, si dhe të gjitha detyrimeve të tjera, të përcaktuara në udhëzimet e Ministrisë së Financave etj.

7.2.Të sigurohet pjesëmarrja në këto trajnime të drejtuesve të programeve buxhetore, drejtuesve të njësive shpenzuese, nëpunësve autorizues, nëpunësve zbatues, drejtuesve të shkollave si dhe specialistëve të tjerë. Detyrimi për trajnimin e stafit dhe drejtorëve të shkollave mbi aspektet e menaxhimit financiar bëhet i domosdoshëm, për faktin se ato autorizojnë pagesat e mësuesve për orët mësimore sipas normës së miratuar dhe ato mbi normë, shpenzimet e transportit të mësuesve dhe nxënësve, subvencionimin e teksteve shkollore për kategoritë vulnerabël, etj.

7.3.DRAP Fier/ ZVA Fier të përgatisë manualin e proceseve të punës, bazuar në modelimin dhe formatet standarde të lëshuara nga struktura përgjegjëse harmonizuese e MFK në Ministrinë e Financave, për të asistuar institucionet në realizimin e këtij procesi.

Periodikisht, në vijimësi

8. -Gjetje nga auditimi:

Parregullsi në evidentimin dhe ndjekjen e detyrimeve debitore dhe kreditore nga strukturat përgjegjëse të DRAP/ZVAP.

8.1.Nuk ka një pasqyrim plotë në kontabilitetin e njësisë shpenzuese të efekteve që rrjedhin nga vendimet gjyqësore të formës së prerë. Konstatohet se ka mospërputhje midis shumave të vendosura në bilanc (llogaria 467, kreditorë të ndryshëm), ku shuma e efektit të vendimeve gjyqësore më datën 31.12.2018, në kontabilitet paraqitet me tre raste gjithsej, prej 1,874,794 lekë dhe atyre të evidentuara në regjistrin e parashikimit të prokurimeve për vitin 2019, ku zëri pagesa e vendimeve gjyqësore evidentohet për 5,046,163 lekë.

8.2.Në llogarinë 466 “Kreditorë për mallra në ruajtje”, gjendja më datën 31.12.2018 paraqitet në vlerën 1,3 milionë lekë, dhe ku janë regjistruar mjete në ruajtje nga viti 2006, përfshirë shumën 290,000 lekë me emërtesën “*lekët e studentëve*”, sa janë arkëtuar tarifa për regjistrimin në Universitetin e Fierit, që mendohej se do të ngrihej krahas Universitetit të Durrës. Nga verifikimi i kryer mbi librin e arkës mod.K7, të muajit shtator 2006, konstatohet se është mbajtur një procesverbal midis dorëzueses dhe marres në dorëzim të arkës së institucionit, ku është dorëzuar lista e borderosë se derdhjeve të kryera në thesar nga studentet kandidatë, me 148 emra të papaguar. Me kalimin e viteve, shuma të caktuara janë tërhequr nga personat që i kanë derdhur në vijimësi, ndërsa vlera 290 mijë lekë qëndron e ngurtësuar.

8.3.Gjendja e llogarisë 468 “*Debitor të ndryshëm*” paraqitet me vlerën 423,783 lekë, detyrim i cili u përket dy subjekte debitore, e konkretisht:

- a) Firma ██████ në shumën 260 mijë lekë, e krijuar në vitin 2007,
- b) Firma ██████? në shumën 163,783 lekë, e krijuar në vitin 2008,

Konstatohet se këto detyrime debitore kanë një kohë të gjatë që janë krijuar dhe nuk kanë rezultuar të arkëtohen, dhe si zanafillë e detyrimeve të krijuara janë auditimet e bëra nga Ministria e Arsimit, Sporteve dhe Rinisë.

Sa sipër, nuk kanë gjetur zbatim kërkesat e Ligjit nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, i ndryshuar ; Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar; Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”; i ndryshuar dhe Udhëzimit të Ministrit të

Financave dhe Ekonomisë nr.8, datë 09.03.2018 “Për Procedurat e Përgatitjes, Paraqitjes dhe Raportimit të Pasqyrave Financiare Vjetore të Njësive të Qeverisjes së Përgjithshme”
(Më hollësisht trajtuar në pikën 3, faqe 27-56 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

8.-Rekomandimi:

8.1.Drejtori i DRAP dhe drejtori ZVAP të analizojnë situatën e detyrimeve debitore dhe kreditore dhe të vendosin në kushtet e arkëtimit vlerat e debive të regjistruara në kontabilitet.

Të dërgohen shkresa zyrtare për arkëtimin e detyrimeve, për debitorët që janë me shpresë arkëtimi, ndërsa për debitorët që janë pa ndonjë shpresë arkëtimi, ti propozohet Ministrisë së Financave që ti mbajnë në llogaritë jashtë bilancit, ose të ndiqet procedurat ligjore për parashkrimin e tyre. Për subjektet private debitore të dërgohen shkresa Drejtorisë së Tatimeve, për të njoftuar për detyrimet që ato kanë ndër vite dhe të merren hapat bashkëpunimi ndërmjet dy institucioneve, për të mundësuar arkëtimin e këtyre detyrimeve.

8.2.Për një pasqyrim te drejtë ne kontabilitet te të drejtave dhe detyrimeve, nga ana e Sektorit të Financës të merren masat për identifikimin e personave që kanë bërë derdhjet e tarifës së regjistrimit për në universitet nga 2000 lekë/student, proces ky i pa finalizuar, dhe të merren masat për njoftimin e tyre, meqenëse këto vlera mbahen/administrohen padrejtësisht dhe sa sipër lihet rekomandim që këto shuma t’u kthehen personave respektivë që kanë bërë derdhjet.

Menjëherë

D. MASA PËR ELIMIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCË DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE.

1. -Gjetje nga auditimi:

Shpenzime joefektive për buxhetin e shtetit, nga ekzekutimi i vendimeve gjyqësore për largimin e padrejtë nga puna të punonjësve në vlerën e paguar për 4 persona në periudhën objekt auditimi prej 2,892,064 lekë.

E gjithë shuma për ekzekutimin këtyre vendimeve gjyqësore, është një shpenzim joefektiv për buxhetin e shtetit duke qenë se i përket vendimmarrjeve të gabuara për largim nga puna, ku përfshihen dhe pagesat e tarifave përmbartimore dhe të shpenzimeve gjyqësore në vleftën 2,892,064 lekë.

Këto veprimet janë në kundërshtim me Ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar me ligjin nr.110/2015 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 10296, datë 8.7.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”; dhe Ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 3, faqe 27-56 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

1.1.-Rekomandimi:

DRAP/ZVAP të analizojë dhe nxjerrë përgjegjësitë për shumatat e shpenzuara për ekzekutimin vendimeve gjyqësore, prej **2,892,064 lekë**, si shpenzime joefektive për buxhetin e shtetit, pasi u përkasin vendimmarrjeve të gabuara për largim nga puna, dhe shpenzime gjyqësore dhe të mos lejojë kryerjen e pagesave të kësaj kategorie pa analizuar dhe nxjerrë përgjegjësitë për vendimmarrjet e gabuara të largimit të padrejtë nga puna.

Menjëherë dhe në vijimësi

2. -Gjetje nga auditimi:

Shpenzime joefektive për buxhetin e shtetit, si pasojë e kalimit në shpenzime të vlerës së gjobës së ekzekutuar nga ana e Drejtorisë së Rajonale të Tatimeve për vonesat në deklarimin dhe likuidimin e detyrimeve tatimore dhe të sigurimeve shoqërore në vleftën 292,035 lekë.

Me Urdhër Shpenzimin nr. 117 deri 133, datë 06.05.2019 është likuiduar Dega Rajonale e Sigurimeve Shoqërore Fier me objekt pagesë gjobe DRT Fier, në shumën prej 292,035 lekë.

Nga auditimi i procedurës dhe dokumentacionit bashkangjitur kësaj praktike të likuidimit, rezulton se:

Janë likuiduar kamatëvonesa dhe gjoba të lidhura me mosdeklarimin në sistem dhe për vonesa në likuidim të detyrimeve ndaj sigurimeve shoqërore, në shumën 292,035 lekë, sipas urdhrit të brendshëm lëshuar nga drejtori i DAR me nr.665, datë 03.05.2019 “urdhër për likuidim e detyrimeve tatimore në sistem”, për të cilat nuk ka nxjerrje përgjegjësie dhe nuk ka analizë për pagesën e kryer për likuidim gjobe nga fondet e buxhetit të shtetit..

Si gjetje u konstatua:

Pagesa e kryer për gjobë ndaj Drejtorisë Rajonale të Tatimeve është një kundërvajtje administrative që nuk duhet të mbulohet nga fondet e buxhetit të shtetit, por duhet të ishte shlyer nga personat përgjegjës që ndjekin shpenzimet, ose në rast të kundërt nga shefi i financës së institucionit. Shuma e detyrimeve ndaj D.R Tatimeve është evidentuar në llogarinë 467 prej 241,942 lekë dhe nga vonesat e shlyerjes, kjo shumë është rritur duke marrë penaltitetet nga sistemi dhe në fund të periudhës ka arritur në vleftën 292,035 lekë

Këto veprimet janë në kundërshtim me Ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar me ligjin nr.110/2015 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 10296, datë 8.7.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”; dhe Ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 3 , faqe 27-56 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

2.1.-Rekomandimi:

DRAP Fier/ZVA Fier të analizojë dhe nxjerrë përgjegjësitë për shumën e shpenzuar dhe të marrë masat për vënien në kushtet e zhdëmtimit nga personat përgjegjës për këtë shpenzim joefektiv për buxhetin e shtetit në vleftën prej 292,035 lekë.

Menjëherë dhe në vijimësi

3. -Gjetje nga auditimi:

Shpenzime joefektive për buxhetin e shtetit, si pasojë e kalimit në shpenzime të vlerës së kamatëvonesave ndaj Sh.a Ujësjellësi në vleftën 1057,2 lekë.

Me Urdhër Shpenzimin nr. 360, datë 26.12.2018 është likuiduar Sh.a Ujësjellësi Fier mbi detyrimet e muajit gusht 2018 në shumën prej 11,627 leke, nga e cila 10,570 lekë janë detyrimet dhe 1057,2 leke janë kamatëvonesat për të cilat nuk ka nxjerrje përgjegjësie.

Si gjetje u konstatua:

Shuma e kamatëvonesave të ngarkuar fondeve të buxhetit të shtetit prej 1,057 lekë është shkelje të disiplinës financiare dhe duhet të zhdëmtohet.

Këto veprimet janë në kundërshtim me Ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar me ligjin nr.110/2015 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 10296, datë 8.7.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”; dhe Ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 3 , faqe 27-56 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

3.1.-Rekomandimi:

DRAP Fier/ZVAP Fier të analizojë dhe nxjerrë përgjegjësitë për shumat e shpenzuara dhe të marrë masat për vënien në kushtet e zhdëmtimit nga personat përgjegjës për këtë shpenzim joefektiv për buxhetin e shtetit në vleftën prej 1,057 lekë.

Menjëherë dhe në vijimësi

4. -Gjetje nga auditimi:

Shpenzime joefektive për buxhetin e shtetit, si pasojë e pagesave nga fondet e buxhetit të shtetit, referuar urdhër shpenzimeve të kaluara në thesar për vitin 2018 dhe 2019, të shumës 21,573,204 lekë, për 76 punonjësit e ish- DAR-eve dhe që aktualisht janë pjesë e DRAP Fier, për lirimin nga shërbimi civil të punonjësve dhe humbjen e statusin e nëpunësit civil dhe rregullimin në vijimësi të marrëdhënieve të punësimit sipas dispozitave të Kodit të Punës.

Janë likuiduar shumat prej 21,573,204 lekë, për 76 punonjësit e ish- DAR-eve, që aktualisht janë pjesë e DRAP Fier, për lirimin nga shërbimi civil dhe humbjen e statusin e nëpunësit dhe janë kthyer me kod pune. Kjo praktikë është mbështetur në praktikat e me poshtëshënuara:

1. Urdhri i Kryeministrit me nr. 68, datë 5.4.2019 “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së DP të DRAP” ,
2. Urdhri i MASR me nr. 234, datë 19.4.2019 “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së ZVAP” ,
3. Vendimi i Komisionit të Ristrukturimit me nr. 4980/96, datë 08.05.2019;
4. Shkresat e MFE për çeljet respektive të fondeve për këto kategori që humbasin statusin e nëpunësit.
5. Njoftim për fillimin e procedurës së ristrukturimit/mbylljes së DAR Fier, datë 28.03.2019.
6. Vendimi me nr. 5165/5 prot., datë 14.05.2019 “Vendimi për lirimin nga shërbimi civil”. nënshkruar nga ana Drejtori i Përgjithshëm i DRAP

Pagesa është kryer duke akorduar përgjithësisht nga 6 paga për çdo të punësuar që ka humbur statusin e punësimit, si pasojë e ristrukturimit.

Këto veprimet janë në kundërshtim me Ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar me ligjin nr.110/2015 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 10296, datë 8.7.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”; dhe Ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 3, faqe 27-56 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

4.1.-Rekomandimi:

DRAP Fier/ZVAP Fier në bashkëpunim me DPAP të analizojnë dhe nxjerrin përgjegjësitë për shumat e shpenzuara për këtë shpenzim joefektiv për buxhetin e shtetit.

Menjëherë dhe në vijimësi

5. -Gjetje nga auditimi:

Shpenzime joefektive për buxhetin e shtetit, si pasojë e pagesave nga fondet e buxhetit të shtetit të shpenzimeve për riparim automjeti ne përdorim, pa miratim nga organi epror në shumën 78,500 lekë.

- Në bilancin e DAR Fier për vitin 2017 dhe 2018, gjendja inventariale e llogarisë 215 “Mjete transporti” rezulton për zero lekë. Konstatohet se është hartuar një kontratë me nr. 19/1 date 08.01.2018, e nënshkruar vetëm nga ish-drejtori i DAR dhe pa miratim nga përfaqësuesi i MASR për përdorimin e automjetit të Drejtuesit të DAR për nevojat e

institucionit. Në kushtet që kjo kontratë nuk ka nënshkrimin nga Ministria, nuk ka vlerën e një autorizimi për përdorim të automjetit personal për llogarit të DAR.

- Nuk ka preventiv dhe situacion për artikullin e blerë dhe të vendosur dhe defektin e riparuar, madje në procesverbalin e rasteve të emergjencës, thuhet se blerja është kryer pasi mjete sipas të dhënave në katalog ka plotësuar orët e punës dhe km e përshkruara, pra nuk bëhet fjalë për emergjencë.
- Është vepruar në kundërshtim me përcaktimet e pikse 18 të Udhëzimit të APP me nr.3, datë 08.01.2018 “Për përdorimin e procedurës me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike”, pas nuk ka një dokumentim të defektit dhe situatës së konsideruar emergjencë, ku përcaktohet se,
”Në të tilla raste emergjence ose ku prania e komisionit është e pamundur, blerja apo shërbimi do kryhet në vend pa u respektuar procedurat e parashikuara në këtë udhëzim, në prani të personave (përfaqësues të institucionit) që ndodhen në vend dhe që mbajnë një procesverbal midis tyre për ngjarjen e ndodhur.”
Procesverbali i mbajtur midis personave të pranishëm së bashku me faturën përkatëse të nënshkruar prej tyre, i dorëzohet komisionit të prokurimit me vlerë të vogël, të cilët mbajnë procesverbalin, sipas formularit standard Nr.4, bashkëlidhur, këtij udhëzimi, nënshkruajnë faturën dhe të gjithë dokumentacionin dhe ia dërgojnë Zyrës së Financës për likuidim.
- Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion mungon praktika e marrjes në dorëzim të mallit nga komisioni i marrjes së mallrave dhe shërbimeve përpara se malli të bëhet hyrje në magazinë, në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30 datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësinë e sektorit publik" pika 42-50, pasi nuk ka komision konfirmimi të shërbimit, por është nënshkruar nga ish-drejtori DAR, i cili ka nënshkruar gjithë aktet (*urdhër shpenzimi, urdhër prokurimi, procesverbal i rasteve të emergjencës, fatura, kontrata*).

Këto veprimet janë në kundërshtim me Ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar me ligjin nr.110/2015 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 10296, datë 8.7.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”; dhe Ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar. (*Më hollësisht trajtuar në pikën 3, faqe 27-56 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*)

5.1.-Rekomandimi:

Pagesa e kryer ndaj subjektit privat pa miratim nga Ministria në shumën 78,500 lekë me TVSH është një kundërvajtje administrative që nuk duhet të mbulohet nga fondet e buxhetit të shtetit, por duhet të ishte shlyer nga personat përgjegjës që ndjekin shpenzimet, ose në rast të kundërt nga urdhëruesit/autorizuesit e pagesës. ZVA Fier të analizojë dhe nxjerrë përgjegjësitë për shumat e shpenzuara dhe të marrë masat për vënien në kushtet e zhdëmtimit nga personat përgjegjës për këtë shpenzim joefektiv për buxhetin e shtetit në vleftën prej

Menjëherë dhe në vijimësi

E. MASA DISIPLINORE:

Mbështetur në nenin 37 të Kodit të Punës të Republikës së Shqipërisë, miratuar me ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995, i ndryshuar, Urdhrin e Kryeministrit, nr. 199, datë 01.12.2010 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Drejtorive Arsimore Rajonale dhe Zyrave Arsimore”, Rregulloren e Brendshme me nr. 346 prot., datë 09.10.2019 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Zyrës Vendore të Arsimit Parauniversitar Fier” të miratuar nga titullari i institucionit, si dhe kontratat individuale të punës, referuar përshkrimit të punës dhe detyrave që mbulojnë në

strukturat përkatëse, i kërkoj në bazë të kompetencave Drejtorit të Zyrës së Arsimit Parauniversitar të vlerësojë, në varësi të analizës së përgjegjësisë, shkallën e përgjegjësisë për secilin punonjës të emërtesës së tij në kuadër të varësisë hierarkike dhe institucionale, si dhe mangësisë dhe shkeljeve të konstatuara dhe të trajtuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit, fillimin e procedurave për dhënien e masave disiplinore nga “Vërejtje” deri në “Largim nga puna”, për personat që gjenden me përgjegjësi në këtë Raport Përfundimtar Auditimi.

Në vazhdim

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të Institucioneve Qendrore. Ky vendim përcillet në formë rekomandimi në subjektin e auditimit.

Bujar LESKAJ

K R Y E T A R